

AXHENDA

TITULLI:

Ndryshimi i nevojave për aftësi në Shqipëri

GJETJET E FUNDIT NGA ANKETA EVROPIANE E AFTËSIVE DHE VENDEVE TË PUNËS

VENDI KU DO TË ZHVILLOHET TAKIMI

5 tetor 2023, ora 10:00 – 12:00 (CEST), në Zoom

PËRMBLEDHJE:

Objekti i këtij aktiviteti është të prezantojë gjetjet kryesore për Shqipërinë të mbledhura përmes anketës evropiane të aftësive dhe vendeve të punës¹ dhe diskutimi mbi masat kryesore për politikën që duhen ndërmarrë dhe për mundësitë e reja për zgjerimin e studimeve mbi aftësitë që kërkon tregu i punës, si dhe për të rritur kapacitetet në fushën e informimit mbi aftësitë e nevojshme për punë. Gjetjet dhe analizat janë thelbësore për punën e ETF-së në fushën e aftësive në tregun e punës në vendet e saj partnere, me qëllim forcimin e informimit mbi aftësitë dhe rritjen e mbështetjes për kalimin drejt një zhvillimi të gjelbër dhe dixhital – dhe konsolidimin e politikave të të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe punësimit.

Kjo anketë periodike e Cedefop-it mbledh informacion mbi kërkesat për aftësitë për punë, për dixhitalizimin, mospërputhjet mes aftësive dhe kualifikimeve dhe për të mësuarin në vendin e punës të kampioneve kombëtare të punonjësve në moshë të rritur në fushën e punësimit me paga të rregullta periodike ose me pagesë për punë në njësi kohe. Kjo anketë synon gjithashtu të ofrojë një bazë informimi edhe për debatin mbi politikën që duhen ndërmarrë lidhur me ndikimin e dixhitalizimit në të ardhmen e punës dhe aftësive, si dhe me pasojat e pandemisë COVID-19. Përmes kësaj ankete, mbledhet informacion në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, Norvegji dhe Islandë. Cedefop ka bashkuar forcat me ETF-në, e cila e ka zhvilluar këtë anketim në gjashtë vende partnere (konkretisht në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Kosovë², Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Izrael). Anketa aspiron të bëhet një mjet kyç për një politikëbërje në fushën e arsimit dhe formimit e sidomos sa u përket programeve të rikualifikimit dhe përmirësimit të aftësive duke marrë për bazë të dhënat e mbledhura. Anketa është hartuar në mënyrë të tillë që të përfshijë ambicet për rritje, qëndrueshmëri dhe elasticitetit të Shtyllës Evropiane të të Drejtave Sociale, [Axhendës së BE-së për Aftësi për Punë](#), [Strategjisë Evropiane Dixhitale](#), duke vlerësuar rëndësinë që kanë aftësitë dixhitale të paraqitura gjithashtu edhe në [Rekomandimin e vitit 2020 të Këshillit për AFP-në](#) dhe në [Deklaratën e Osnabrück-ut](#).

¹ Më shumë informacion mbi anketën mund të gjeni [këtu](#).

² Ky përcaktim nuk përbën asnjë paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 dhe Opininionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Takimi do të mbahet në dy gjuhë, në anglisht dhe në shqip, përmes ofrimit të përkthimit simultan.

Ora	Axhenda
10:00 - 10:10	<p>Moderatori – Romain Boitard</p> <p>Fjala e hapjes dhe prezantimi</p> <p><i>Xavier Matheu de Cortada - Shef i Departamentit të Qendrës së Njohurive (ETF)</i> <i>Andrea Ferrero, Shef Seksioni, Delegacioni i BE-së në Shqipëri</i></p>
10:10 - 10:55	<p>Ndryshimi i nevojave për aftësitë për punë. Gjetjet e para nga anketa evropiane e aftësive dhe vendeve të punës në Shqipëri</p> <p><i>Prezantues: Mircea Badescu, Stacionien i Zhvillimit të Kapitalit Njerëzor (ETF)</i></p> <p><i>Pyetje dhe Përgjigje</i></p>
10:55 - 11.50	<p>Anketa Evropiane e Punës dhe Aftësive – implikimet për politikëbërjen dhe studimin shkencor</p> <p>Panel diskutimi</p> <p><i>Kontribuues:</i> <i>Linda Bushati, Specialiste e Arsimit (UNICEF)</i> <i>Michael Johnson, udhëheqës i ekipit të programit IPA</i> <i>Ana Zacharian, Aftësitë shqiptare - Shoqata Kombëtare për Konkurse të Aftësive (Albanian Skills)</i></p> <p><i>Moderatore: Cristina Mereuta, Eksperte e Lartë për Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor - Koordinator për Politikat Aktive të Tregut të Punës (ETF)</i></p>
11:50 - 12.00	<p>Mbyllja</p> <p><i>Romain Boitard, Koordinator për Shqipërinë (ETF)</i></p>